



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Prezenca në Shqipëri**

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË CEREMONINË E DIPLOMIMIT NË  
SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS  
5 tetor 2018**

E nderuar Ministre,

Të nderuar përfaqësues të sistemit të drejtësisë, të Kuvendit të Shqipërisë,

Të nderuar kolegë të trupit diplomatik,

Të nderuar të ftuar dhe, veçanërisht, të dashur të diplomuar!

Kam kënaqësinë të jem sot këtu, me ju, në ceremoninë e diplomimit të një brezi të ri magistratësh. OSBE-ja është dhe do të mbetet e angazhuar të mbështesë shtetin e së drejtës, si dhe një sistem drejtësie që është i drejtë, llogaridhënës, transparent, i qasshëm, dhe efikas. Pavarësia, paanshmëria dhe integriteti i sistemit gjyqësor janë përbërës shumë të rëndësishëm për besimin e qytetarëve tek institucionet publike, funksionimin e mirë të ekonomisë së tregut dhe zhvillimin e një shoqërie të hapur e me diversitet. Profesionistët e fushës së drejtësisë, ku përfshihen edhe ju, përfaqësojnë shtyllat kryesore të konsolidimit të demokracisë në Shqipëri dhe luajnë rol thelbësor për zhvillimin evropian të vendit. Përzgjedhja dhe trajnimi i duhur i profesionistëve të drejtësisë ka rëndësi madhore për ndërtimin e një sistemi gjyqësor efikas, të paanshëm, dhe të pavarur.

Më vjen keq që përzgjedhja e studentëve të rinj të këtij institucioni prestigjioz është bllokuar nga politika. I di argumentet e atyre që e bllokojnë, por ata kritikojnë, ndër të tjera, mekanizmin e përzgjedhjes të brezit të ri, dhe ku ka gjë më të thjeshtë se sa që të gjitha palët të ulen bashkë dhe të diskutojnë nëse ka ide më të mira dhe se si mund të bëhet më mirë përzgjedhja?! Këto janë vendime që duhet të merren në interes të vendit dhe të qytetarëve të tij.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri është krenare që ka qenë partnere e Shkollës së Magjistraturës për një kohe shumë të gjatë. Prej vitesh, ne kemi dhënë kontribut për trajnimin e gjyqtarëve dhe të profesionistëve të tjerë të fushës së drejtësisë për një larmi çështjesh ligjore që përfshijnë burgjet dhe shërbimin e provës, drejtësinë administrative dhe së fundi në menaxhimin e çështjeve.

Dëshiroj të përdor këtë mundësi për të falënderuar Drejtorin Sokol Sadushi për partneritetin tonë të vazhdueshëm. Ne e vlerësojmë shumë gatishmërinë tuaj për të qenë partner me ne dhe jemi të gatshëm të vazhdojmë këtë partneritet të gjatë dhe të suksesshëm.

Të gjithë pjesëmarrësit në këtë aktivitet i njohin vështirësitë me të cilat përballet sistemi gjyqësor i Shqipërisë. Reforma në drejtësi është tema e ditës. Qytetarët shqiptarë kanë pak besim te sistemi gjyqësor, sikurse tregohet nga shumë sondazhe të kryera. Ndërkohë, është duke u kryer procesi shumë i rëndësishëm i vettingut të profesionistëve të drejtësisë, çka bën rrit vëmendjen e publikut dhe të ndërkombëtarëve dhe shërben si shembull për të tërë rajonin e më gjerë. Ju vetë do ta ndieni këtë vëmendje kundrejt reformës së sistemit gjyqësor përgjatë

punës suaj në të ardhmen, kur më në fund të emëroheni. Këshilla jonë është: merrni zemër nga kjo mbështetje! Ndihehi mbështetjen që keni që të bëheni gjykatës të pavarur dhe të ndershëm. Kjo do të thotë edhe të kini parasysh që parasysh që veprimet tuaja kanë pasoja. Procesi i vettingut po vijon. Një numër i madh gjyqtarësh po i shohin pasojat tashmë. Kini parasysh që çdo vendim që do të merrni do të vërtetohet njohuritë, fuqinë, integritetin dhe përkushtimin tuaj kundrejt shtetit të së drejtës dhe zhvillimit të vendit tuaj. Kini parasysh betimin që do kryeni, citoj: *“Betohe me solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do të respektoj rregullat e etikës profesionale”*. Me pak fjalë, kjo është ajo që pritet prej jush.

Thënë kjo, ju përgëzoj edhe njëherë për diplomimin, një arritje madhore kjo, në këtë institucion prestigjioz dhe ju uroj një karrierë të suksesshme në një sistem drejtësie të pavarur në shërbim të qytetarëve të vendit tuaj.

Faleminderit shumë për vëmendjen!